



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 05 Maj 2021

Nr: 353

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Agjencisë Telegrafike Shqiptare

Kërkues: Partia Demokratike e Shqipërisë

Ndaj: Agjencisë Telegrafike Shqiptare

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n’, pika 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I.

Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë raportuar dy denoncime në ndërfaqen e “Aktiviteteve të



Ndaluara”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë për një veprimtari të Agjencisë Telegrafike Shqipëtare, e cila sipas denoncuesit bie në kundërshtim me vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

Kallëzimi i paraqitur nga kallëzuesi ruhet në sistem elektronik dhe identifikohen me numër unik të gjeneruar nga sistemi.

Në denoncimin e raportuar më datë 20.03.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2396, ora 20:18, pretendohet se, *“Në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, Agjencia Telegrafike Shqiptare, institucion në varësi direkte të Kryeministrit, është përfshirë në fushatë jo vetëm duke propaganduar lajme në favor të qeverisë por madje edhe duke zhvilluar dhe propaganduar sondazhe që nxjerrin fitues Partinë Socialiste”*. Në denoncimin e raportuar më datë 04.04.2021 me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2839, ora 19:02 në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet se: *“Agjencia Telegrafike Shqiptare, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, është përfshirë drejtpërdrejt në fushatë në mbështetje të Partisë Socialiste, duke transmetuar live dhe propaganduar vetëm aktivitete të kësaj force politike.*

Neni 65 “Verifikimi paraprak përpara fillimit të procedurës administrative” i Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikon se:

“Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

- a) nëse të drejtat apo interesat e kërkuara nga palët janë subjekt i ndonjë kufizimi kohor;*
- b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative;*
- c) nëse afati i përcaktuar me ligj për dorëzimin e kërkesës është respektuar;*
- ç) nëse kërkesa e një pale për fillimin e një procedure administrative mund të shqyrtohen së bashku me kërkesat e palëve të tjera, nëse bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore.”*

Meqenëse në KQZ janë paraqitur dy kërkesa nga Partia Demokratike e Shqipërisë, pra nga i njëjti subjekt, që trajtojnë çështje të së njëjtës natyrë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, shqyrtimin së bashku të kërkesave të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike e Shqipërisë përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Referuar nenit 7, të ligjit 10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijojë procedurën administrative ndaj Agjencisë Telegrafike Shqiptare ndaj të cilit atribuohen veprimtari administrative, që vijnë në kundërshtim me parashikimet e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

II.

Rrethanat e faktit

Komisioni Rregullator në KQZ, më datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9, datë 24.10.2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020. Gjithë të interesuarit mund të disponojnë përmbajtjen e tij nëpërmjet faqes zyrtare të KQZ-së, në rubrikën “Vendime” dhe kategorinë “Vendime të Rregullatorit” duke filluar nga kjo datë.

Në denoncimet e raportuar pretendohet se Agjencia Telegrafike Shqiptare ka shkelur nenin 3, nëndarja 1.3, shkronja “c” dhe “ç” të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 4170 prot., datë 21.04.2021, i ka kërkuar Agjencisë Telegrafike informacion sqarues në lidhje me pretendimet e subjektit denoncues Partia Demokratike e Shqipërisë.

Me shkresën nr. 243/1, datë 26.04.2021 protokolluar pranë KQZ-së me shkresën nr. 4170/1 prot., datë 26.04.2021, Agjencia Telegrafike Shqiptare ka dhënë pretendimet e saj duke sqaruar se, publikimi i sondazheve dhe transmetimeve të kryera nga ky institucion janë në përputhje me rregulloren e saj si dhe aktet normative, që vendosin veprimtarinë e agjencisë brenda kuadrit ligjor të saj.

III. Analiza ligjore

Në nenin 91, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar parashikohet se, *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.*

Referuar denoncimit të mësipërm, sqarojmë se Agjencia Telegrafike Shqiptare është njësi zyrtare e lajmeve të qeverisë shqiptare. Kjo agjenci publikon lajme rreth vendit në disa gjuhë të huaja dhe ka për detyrë të informojë mbi të gjithë **aktivitetin politik**, ekonomik, kulturor dhe shoqëror që zhvillohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo nga bota. Ky aktivitet kryhet nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, gjatë 24 orëve.

Në denoncimet e raportuara pretendohet se Agjencia Telegrafike Shqiptare ka shkelur nenin 3, nëndarja 1.3, shkronja “c” dhe “ç” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, ku parashikohet shprehimisht se konsiderohet veprimtari e ndaluar:

c) vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel

qendror ose të njërive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit;

ç) përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në vlerësim të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, konstaton se, nuk rezultoi e provuar se ATSH është në shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ për këto arsye:

- 1- Agjencia Telegrafike Shqiptare, **në ushtrim të detyrave të saj**, ka për detyrë të informojë çdo individ në mënyrë të saktë dhe të balancuar, duke publikuar jo vetëm sondazhe, por edhe aktivitete të çdo subjekti zgjedhor. Nga informacioni i disponuar gjatë hetimit administrativ, rezulton se ATSH ka publikuar jo vetëm informacione rreth Partisë Socialiste të Shqipërisë, por gjithashtu ka publikuar rreth 300 lajme mbi aktivitetet e Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe rreth 50 lajme rreth Lëvizjes Socialiste për Integrim, si dhe ndaj subjekteve të tjera zgjedhore. Këto lajme, sondazhe apo informacione janë publikuar **duke cituar vetëm burimin** dhe nuk ka pasur komente nga ATSH. Për këtë arsye, vlerësoj se në këtë rast nuk kemi vënie në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore nga ana e ATSH-së.
- 2- Agjencia Telegrafike Shqiptare, si mision parësor në veprimtarinë e saj ka mbledhjen, përpunimin dhe transmetimin online përmes faqes së saj zyrtare të internetit www.ata.gov.al. Publikimi i veprimtarive të pretenduara nga denoncuesi **është në ushtrim të detyrave dhe funksioneve** të parashikuara nga ligji dhe akteve nënligjore mbi të cilat ATSH- kryen veprimtarinë e saj. Kryerja e këtyre detyrave, nga punonjësit e ATSH-së, nuk përbën përdorim të tyre për qëllime zgjedhore. Për këto arsye vlerësoj se nuk jemi në ndalimin e parashikuar në nenin 3, nëndarja 1.3, shkronja “ç” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga Partia Demokratike e Shqipërisë, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se, veprimtaria Agjencisë Telegrafike Shqiptare, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n”, pika 2, dhe nenet 91, 92, 171/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 3 pika 2 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe nenet 17,18,19 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative.

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Agjencisë Telegrafike Shqiptare pasi nuk konstatohen shkelje vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

